



REPUBLIKA E KOSOVËS - РЕПУБЛИКА КОСОВО - REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA KUSHTETUESE
УСТАВНИ СУД
CONSTITUTIONAL COURT

Prishtinë, më 5 tetor 2017
Nr. ref.: RK 1132/17

AKTVENDIM PËR PAPRANUESHMËRI

në

rastin nr. KI53/17

Parashtrues

X

Vlerësim i kushtetutshmërisë së Aktgjykimit të Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 50/2017, të 20 marsit 2017

GJYKATA KUSHTETUESE E REPUBLIKËS SË KOSOVËS

e përbërë nga:

Arta Rama-Hajrizi, kryetare
Ivan Čukalović, zëvendëskryetar
Altay Suroy, gjyqtar
Almiro Rodrigues, gjyqtar
Snezhana Botusharova, gjyqtare
Bekim Sejdiu, gjyqtar
Selvete Gërzhaliu-Krasniqi, gjyqtare dhe
Gresa Caka-Nimani, gjyqtare

Parashtruesi i kërkesës

1. Kërkesa u parashtrua nga i mituri X (në tekstin e mëtejme: parashtruesi i kërkesës), i përfaqësuar nga Fitim Shporta, avokat nga Prizreni.

Vendimi i kontestuar

2. Vendimi i kontestuar është Aktgjykimi i Gjykatës Supreme të Kosovës, Pml. nr. 50/2017, i 20 marsit 2017 (në tekstin e mëtejme: Gjykata Supreme), me të cilin ishte refuzuar si e pabazuar kërkesa e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë kundër Aktvendimit të Gjykatës së Apelit (Aktvendimi PAM. nr. 73/2016, i 22 dhjetorit 2016).
3. Aktgjykimi i kontestuar i Gjykatës Supreme iu dorëzua parashtruesit të kërkesës më 5 prill 2017.

Objekti i çështjes

4. Objekt i çështjes është vlerësimi i kushtetutshmërisë së aktgjykimit të kontestuar, me të cilin pretendohet se janë shkelur të drejtat e parashtruesit të kërkesës, të garantuara me nenin 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm], nenin 50 [Të Drejtat e Fëmijës], të Kushtetutës së Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Kushtetuta) në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: KEDNJ), si dhe nenet 3 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.
5. Parashtruesi paraqiti kërkesë për moszbulimin e identitetit për shkak të miturisë së tij.

Baza juridike

6. Kërkesa bazohet në nenin 113.7 të Kushtetutës, në nenet 22 dhe 47 të Ligjit për Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës, nr. 03/L-121 (në tekstin e mëtejme: Ligji) dhe në rregullin 29 të Rregullores së punës së Gjykatës Kushtetuese (në tekstin e mëtejme: Rregullorja e punës).

Procedura në Gjykatën Kushtetuese

7. Më 26 prill 2017, parashtruesi i kërkesës e dorëzoi kërkesën në Gjykatën Kushtetuese të Republikës së Kosovës (në tekstin e mëtejme: Gjykata).
8. Më 27 prill 2017, Kryetarja e Gjykatës caktoi gjyqtarin Ivan Čukalović gjyqtar raportues dhe Kolegjin shqyrtues, të përbërë nga gjyqtarët: Snezhana Botusharova (kryesuese), Bekim Sejdiu dhe Selvete Gërzhaliu-Krasniqi.
9. Më 4 maj 2017, Gjykata njoftoi parashtruesin për regjistrimin e kërkesës dhe i dërgoi një kopje të kërkesës Gjykatës Supreme të Kosovës.
10. Më 5 shtator 2017, Kolegji shqyrtues shqyrtoi raportin e gjyqtarit raportues dhe i rekomandoi Gjykatës papranueshmërinë e kërkesës.

Përmbledhja e fakteve

11. Më 29 gusht 2016, Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti për të mitur (në tekstin e mëtejme: Gjykata Themelore), Aktvendimi PM. nr. 105/2015, pas mbajtjes së shqyrtimit gjyqësor në seancë jopublike, dhe në prezencën e parashtruesit, të miturve tjerë, përfaqësuesve ligjorë, zyrtarit të Shërbimit Sprovues dhe Prokurorit të Shtetit, ndaj parashtruesit shqiptoi masën edukuese, përkatësisht dërgimin e tij në Institucionin Edukativo-Korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti.
12. Gjykata Themelore në Prizren, kishte konstatuar se parashtruesi i kërkesës kishte kryer 3 (tri) vepra penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1. lidhur me nenin 31 të Kodit Penal të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPK), 1 (një) vepër penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje nga neni 327, paragrafi 2, nënparagrafi 2.3 lidhur me nenin 31 të KPK-së dhe 1 (një) vepër penale vjedhje e rëndë në bashkëkryerje në tentativë nga neni 327, paragrafi 1, nënparagrafi 1.1 lidhur me nenet 28 dhe 31 të KPK-së.
13. Më 21 tetor 2016, parashtruesi paraqiti ankesë në Gjykatën e Apelit kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës Themelore. Në ankesën e tij, parashtruesi i kërkesës kryesisht pretendoi shkelje të ligjit penal, për arsye se Gjykata Themelore nuk kishte vlerësuar në mënyrë të drejtë dhe të plotë rrethanat lehtësuese, dhe si rrjedhojë, parashtruesit nuk i kishte shqiptuar masë edukuese më të butë apo dënim me kusht. Më tej, parashtruesi kishte kërkuar nga Gjykata e Apelit që ta njoftojë atë për mbajtjen e seancës së Kolegjit të Gjykatës së Apelit.
14. Më 22 dhjetor 2016, Gjykata e Apelit (Aktvendim PAM. nr. 73/2016) e refuzoi ankesën e parashtruesit si të pabazuar dhe e vërtetoi Aktvendimin e Gjykatës Themelore të 29 gushtit 2016.
15. Në aktvendimin e saj, Gjykata e Apelit konstatoi: *“[...] pretendimet e mbrojtësve të të miturve që masat edukative institucionale të shqiptuara ndaj të miturve, janë të ashpra dhe të njëjta duhet të zëvendësohen me masa më të buta janë të pabazuara, meqenëse në ankesat e mbrojtësve të të miturve nuk ka rrethana konkrete lehtësuese të cilat nuk kanë qenë objekt shqyrtimi nga gjykata e shkallës së parë e që kishin me ndikuar në zbutjen, ndryshimin e masës së shqiptuar, andaj Gjykata e Apelit, konsideron se gjykata e shkallës së parë, drejtë i ka vlerësuar të gjitha rrethanat të cilat kanë ndikuar në shqiptimin e masave edukative, përfshirë këtu edhe raportin e shërbimit sprovues, pra, kohëzgjatjen e masës edukative e shqiptuar të miturve është në përputhje me rrethanat e konstatuara dhe të vlerësuara dhe në interesin më të mirë të tyre. [...]”*
16. Më 2 shkurt 2017, parashtruesi paraqiti kërkesë për mbrojtje të ligjshmërisë në Gjykatën Supreme kundër aktvendimit të lartcekur të Gjykatës së Apelit.
17. Në kërkesën e tij për mbrojtje të ligjshmërisë, parashtruesi i kërkesës pretendoi shkelje të nenit 390, paragrafit 1 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës (në tekstin e mëtejme: KPPK), për arsye se seanca e Kolegjit për të mitur në

Gjykatën e Apelit ishte mbajtur pa praninë e tij, përkundër kërkesës së parashtruesit që të njoftohet për mbajtjen e kësaj seance. Në lidhje me këtë, parashtruesi po ashtu pretendoi shkelje të nenit 31 të Kushtetutës, të nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe të neneve 3 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.

18. Më 20 mars 2017, Gjykata Supreme (Aktgjykimi Pml. nr. 50/2017) e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë.
19. Përkitazi me pretendimin e parashtruesit për njoftim për mbajtjen e seancës së Kolegjit, Gjykata Supreme vlerësoi se:

“[...] nuk qëndrojnë pretendimet e cekura e duke u nisur nga fakti se dispozita e nenit 390, par. 1 të KPP-së, thekson se kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e Kolegjit të Apelit i dërgohet Prokurorit kompetent të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij.

Qëndron fakti se të miturit [parashtruesit] i është shqiptuar masa edukative institucionale – dërgimi i të miturit në Institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej 1 viti, por kjo masë nuk është dënim me burgim ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 390 par. 1 të KPPK-së. Po ashtu dispozita e nenit 5 të Kodit të drejtësisë për të mitur parasheh se dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës penale të Kosovës, Ligjit mbi ekzekutimin të sanksioneve penale dhe të çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe. Andaj në rastin konkret, me të drejt Gjykata e Apelit të Kosovës ka aplikuar dispozitën e nenit 390 par. 1 të KPPK-së, kur nuk ka njoftuar për seancën e kolegjit as të miturin as mbrojtësin e tij.”

Pretendimet e parashtruesit të kërkesës

20. Parashtruesi i kërkesës pretendon se Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur dispozitat e procedurës penale, si dhe të drejtat e tij të garantuara me nenet 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm] dhe 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës, në lidhje me nenin 6 (E drejta për një proces të rregullt) të KEDNJ-së, si dhe nenet 3 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.
21. Në lidhje me këtë, parashtruesi pohon se *“duke marrë parasysh interesat më të larta të fëmijës, nuk ia ka mundur të miturit dhe përfaqësuesit të tij të dëgjohet në seancën e Kolegjit të Apelit, ngase fëmiut dhe mbrojtësit të tij duhet t'i jepet mundësia që të dëgjohet në çdo procedurë gjyqësore që ka të bëjë me çështjen e tij.”*

Dispozitat relevante të Kushtetutës, Konventës Evropiane për të Drejtat e Njeriut dhe Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Kodit të procedurës penale dhe Kodit të drejtësisë për të mitur

Kushtetuta

Neni 31 [E Drejta për Gjykim të Drejtë dhe të Paanshëm]

“1. Çdokujt i garantohet mbrojtje e barabartë e të drejtave në procedurë para gjykatave, organeve të tjera shtetërore dhe bartësve të kompetencave publike.

2. Çdokush gëzon të drejtën për shqyrtim publik të drejtë dhe të paanshëm lidhur me vendimet për të drejtat dhe obligimet ose për cilëndo akuzë penale që ngrihet kundër saj/tij brenda një afati të arsyeshëm, nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e themeluar me ligj.

[...]

Neni 50 [Të Drejtat e Fëmijës]

[...]

4. Të gjitha veprimet që kanë të bëjnë me fëmijët, të ndërmarra qoftë nga institucionet e pushtetit publik, qoftë nga institucionet private, do të jenë në interesin më të mirë të fëmijëve.

[...]

Konventa Evropiane për të Drejtat e Njeriut

Neni 6 [E drejta për një proces të rregullt], i KEDNJ-së:

“1. Çdo person ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar me ligj, e cila do të vendosë si për mosmarrëveshjet në lidhje me të drejtat dhe detyrimet e tij të natyrës civile, ashtu edhe për bazueshmërinë e çdo akuze penale në ngarkim të tij.”

Konventa për të Drejtat e Fëmijës

Neni 3

“1. Në të gjitha vendimet që kanë të bëjnë me fëmijën, të marra qoftë nga institucione publike ose private të përkrahjes shoqërore, nga gjykatat, autoritetet administrative apo organet legjislative, interesi më i lartë i fëmijës duhet të jetë konsiderata mbizotëruese.”

[...]

Neni 8

“Shtetet Palë marrin përsipër të respektojnë të drejtën e fëmijës për të ruajtur identitetin e tij, përfshirë këtu shtetësinë, mbiemrin dhe lidhjet familjare, sipas ligjit, pa ndërhyrje të paligjshme.”

Neni 12

[...]

“2. Për këtë qëllim, fëmijës i jepet mundësia që të dëgjohej në çdo procedurë gjyqësore ose administrative, që ka të bëjë me të, qoftë drejtpërdrejt, qoftë nëpërmjet një përfaqësuesi ose të një organi të përshtatshëm, në përputhje me rregullat e procedurës së legjislacionit kombëtar.”

Neni 40

1. Shtetet Palë i njohin çdo fëmijë të dyshuar, të akuzuar ose për të cilin është thënë se ka kryer shkelje të ligjit penal, të drejtën e një trajtimi të tillë, që zhvillon te fëmija ndjenjën e dinjitetit dhe të vlerës së personit, që përforcon tek ai ndjenjën e respektit të tij për të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të të tjerëve dhe që merr parasysh moshën e fëmijës si dhe dëshirën për të ndihmuar në riintegrimin e tij në shoqëri dhe në mënyrë që ai të luajë një rol konstruktiv në gjirin e saj.

2. Për këtë qëllim dhe duke pasur parasysh dispozitat përkatëse të instrumenteve ndërkombëtare, Shtetet Palë kujdesen në veçanti që:

[...]

(vii) Të respektohet plotësisht jeta e tij private në të gjitha fazat e procedurës.”

Kodi i procedurës penale

Neni 390 [Seanca para Kolegjit të Apelit]

“1. Kur të akuzuarit i është shqiptuar dënimi me burgim, njoftimi për seancën e Kolegjit të Apelit i dërgohet Prokurorit kompetent të Shtetit, të dëmtuarit, të akuzuarit dhe mbrojtësit të tij”.

[...]

Kodi i drejtësisë për të mitur nr. 03/L-193

Neni 5

“Dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës Penale të Kosovës, Ligjit mbi Ekzekutimin e Sanksioneve Penale dhe të çdo ligji

tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është rregulluar ndryshe”.

Pranueshmëria e kërkesës

22. Gjykata së pari shqyrton nëse parashtruesi i ka përmbushur kriteret për pranueshmëri të kërkesës, të përcaktuara në Kushtetutë dhe më tej të parapara në Ligj dhe të specifikuar në Rregullore të punës.

23. Në këtë drejtim, Gjykata i referohet nenit 113 [Juridiksioni dhe Palët e Autorizuara] të Kushtetutës, i cili përcakton:

“1. Gjykata Kushtetuese vendos vetëm për rastet e ngritura para gjykatës në mënyrë ligjore nga pala e autorizuar.

[...]

7. Individët janë të autorizuar të ngrenë shkeljet nga autoritetet publike të drejtave dhe lirive të tyre individuale, të garantuara me Kushtetutë, mirëpo vetëm pasi të kenë shteruar të gjitha mjetet juridike të përcaktuara me ligj”.

24. Gjykata vëren se parashtruesi është palë e autorizuar në pajtim me Kushtetutën, konteston një akt të autoritetit publik, në këtë rast Aktgjykimin e Gjykatës Supreme, ka shteruar të gjitha mjete e nevojshme juridike dhe ka dorëzuar kërkesën e tij brenda afatit 4 (katër) muaj pas pranimit të aktgjykimit.

25. Megjithatë, Gjykata i referohet edhe nenit 48 [Saktësimi i kërkesës] të Ligjit, i cili parasheh se:

“Parashtruesi i kërkesës ka për detyrë që në kërkesën e tij të qartësoj saktësisht se cilat të drejta dhe liri pretendon se i janë cenuar dhe cili është akti konkret i autoritetit publik të cilin parashtruesi dëshiron ta kontestoj”.

26. Gjykata po ashtu rikujton rregullin 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, i cili përcakton:

“(1) Gjykata mund ta shqyrtojë një kërkesë nëse:

[...]

d) kërkesa arsyetohet prima facie ose nuk është qartazi e pabazuar.

(2) Gjykata do të deklarojë një kërkesë si qartazi të pabazuar, nëse bindet se:

[...]

(b) faktet e paraqitura në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë pretendimin për shkeljen e një të drejte kushtetuese, [...]

(d) parashtruesi nuk dëshmon në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.”

27. Gjykata rikujton që parashtruesi në thelb pretendon se Gjykata e Apelit ka cenuar të drejtën e tij për të qenë i ftuar dhe i pranishëm në seancën e Kolegjit pranë Gjykatës së Apelit, ashtu siç parashihet me nenin 390 (1) të KPPK-së. Në lidhje me këtë, ai pretendon shkelje të neneve 31 dhe 50 të Kushtetutës, të nenit 6 të KEDNJ-së dhe neneve 3 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës.
28. Gjykata thekson se në pajtim me nenin 53 [Interpretimi i Dispozitave për të Drejtat e Njeriut] të Kushtetutës, *“të drejtat e njeriut dhe liritë themelore të garantuara me këtë Kushtetutë, interpretohen në harmoni me vendimet gjyqësore të Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut”*.
29. Gjykata, duke ju referuar praktikës së Gjykatës Evropiane për të Drejtat e Njeriut (në tekstin e mëtejme: GJEDNJ), thekson se *“e drejta për seancë publike siç garantohet me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së domosdo nënkupton të drejtën për një “seancë gojore”* (shih rastin e Gjykatës Kushtetuese KI74/16, X, Aktvendim për papranueshmëri i 10 nëntorit 2016, paragrafi 30, shih po ashtu, *mutatis mutandis* rastin e GJEDNJ-së, *Döry kundër Suedisë*, kërkesa nr. 28394/01, Aktgjykim i 12 nëntorit 2002, paragrafi 37).
30. Si rrjedhojë, parimi i mbajtjes së seancës gojore dhe publike në kontekst penal ka rëndësi të posaçme, me ç’rast, personit të akuzuar me kryerjen e veprës penale në përgjithësi, duhet t’i ofrohet mundësia që të jetë i pranishëm fizikisht në seancën e gjykatës së shkallës së parë që i plotëson të gjitha kriteret e nenit 31 të Kushtetutës dhe të nenit 6 të KEDNJ-së (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI68/16, *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 qershorit 2017, paragrafi 41, shih po ashtu rastin e GJEDNJ-së *Jussila kundër Finlandës*, kërkesa nr. 73053/01, [DHM], Aktgjykim i 23 nëntorit 2006, paragrafi 40).
31. Megjithatë, Gjykata duke ju referuar edhe praktikës së vet gjyqësore dhe asaj të GJEDNJ-së, konsideron se prania personale e të akuzuarit nuk ka rëndësi kritike në seancën e apelit sikurse në seancën e gjykimit. *“Mënyra se si neni 31 i Kushtetutës dhe neni 6 i Konventës zbatohen në procedurë në gjykatat e apelit, varet nga tiparet e veçanta të procedurës në zhvillim dhe, se duhet të merren parasysh procedurat si tërësi, në rendin juridik dhe roli i Gjykatës së Apelit në atë rend juridik”* (Shih rastet e Gjykatës Kushtetuese, KI68/16, *Fadil Rashiti*, Aktvendim për papranueshmëri i 2 qershorit 2017, paragrafi 42 dhe KI74/16, X, Aktvendim për papranueshmëri i 10 nëntorit 2016, paragrafi 32, shih po ashtu, *mutatis mutandis*, rastin e GJEDNJ-së, *Hermi kundër Italisë*, kërkesa nr. 18114/02, Aktgjykim i 18 tetorit 2006, paragrafi 60).
32. Në rastin konkret, Gjykata vëren se gjykata e shkallës së parë ka përmbushur kriterin për mbajtjen e seancës publike dhe gojore sepse seancat e shqyrtimit gjyqësor ishin zhvilluar në praninë personale të parashtruesit dhe mbrojtësit të tij dhe të palës akuzuese. Gjykata po ashtu rikujton se Gjykata Themelore, pas

- konstatimit se parashtruesi kishte kryer veprat e lartpërmendura penale, atij i kishte shqiptuar masën edukuese.
33. Si rrjedhojë, Gjykata konsideron se gjykata e shkallës së parë, përkatësisht Gjykata Themelore ka përmbushur kriterin për mbajtjen e “seancës gojore” në pajtim me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së.
 34. Gjykata më tej rikujton se parashtruesi në ankesën e tij të paraqitur në Gjykatën e Apelit kryesisht kishte pretenduar shkelje të ligjit penal dhe kishte kërkuar që të njoftohej dhe të ftohej në seancën e Kolegjit të Apelit.
 35. Gjykata vëren se në procedurën e apelit, Gjykata e Apelit vetëm konfirmoi Aktgjykimin e Gjykatës Themelore në bazë të fakteve të përcaktuara nga Gjykata Themelore.
 36. Prandaj, Gjykata konstaton se parashtruesi i kërkesës në procedurë para Gjykatës së Apelit nuk ishte privuar nga të drejtat dhe garancitë e parapara me nenin 31.2 të Kushtetutës dhe nenin 6.1 të KEDNJ-së, në lidhje me një seancë publike dhe gojore.
 37. Më tej, Gjykata vëren se Gjykata Supreme e refuzoi si të pabazuar kërkesën e parashtruesit për mbrojtje të ligjshmërisë, duke u mbështetur në nenin 390.1 të KPPK-së dhe nenit 5 të Kodit për të Mitur.
 38. Gjykata Supreme në interpretimin e saj të këtyre dispozitave vlerësoi se: *“Qëndron fakti se të miturit [parashtruesit] i është shqiptuar masa edukative institucionale-dërgimi i të miturit në Institucionin edukativo-korrektues në kohëzgjatje prej 1 (një) viti, por kjo masë nuk është dënim me burgim ashtu siç e parasheh dispozita e nenit 390 par. 1 të KPPK-së. Po ashtu dispozita e nenit 5 të Kodit të drejtësisë për të mitur parasheh se dispozitat e Kodit Penal të Kosovës, Kodit të Procedurës penale të Kosovës, Ligjit mbi ekzekutimit të sanksioneve penale dhe të çdo ligji tjetër relevant do të zbatohen për të miturit, përpos rasteve kur me këtë Kod është paraparë ndryshe”.*
 39. Prandaj, Gjykata konstaton se arsyetimi i dhënë nga Gjykata Supreme, duke iu referuar pretendimeve të parashtruesit të kërkesës për shkelje të ligjit të procedurës penale, është i qartë dhe, pas shqyrtimit të të gjitha procedurave, Gjykata gjithashtu konstatoi se procedurat në gjykatat e rregullta nuk kanë qenë të padrejta apo arbitrare (Shih rastin *Shub kundër Lituaniës*, nr. 17064/06, GJEDNJ, Vendimi i 30 qershorit 2009).
 40. Përkitazi me pretendimet e parashtruesit për shkelje të nenit 50 [Të Drejtat e Fëmijës] të Kushtetutës, dhe të neneve 3 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës, Gjykata vëren se parashtruesi nuk ka prezantuar dëshmi *prima facie* ose ka mbështetur pretendimin e tij se si Gjykata e Apelit dhe Gjykata Supreme kanë shkelur të drejtat e tij.
 41. Fakti i thjeshtë që parashtruesi i kërkesës nuk pajtohet me rezultatin e rastit të tij, nuk mund të ngrejë kërkesë të argumentuar për shkelje të të drejtave të tij të mbrojtura me Kushtetutë, KEDNJ dhe Konventën Evropiane për të Drejtat e

Fëmijës (Shih rastin e Gjykatës Kushtetuese, KI125/11, *Shaban Gojnovci*, Aktvendim për papranueshmëri i 28 majit 2012, paragrafi 28).

42. Në rastin konkret, Gjykata konsideron se faktet e paraqitura nga parashtruesi i kërkesës në asnjë mënyrë nuk e arsyetojnë shkeljen e pretenduar të neneve 31 dhe 50 të Kushtetutës, të nenit 6 të KEDNJ-së, si dhe neneve 3 dhe 12 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës dhe se parashtruesi nuk e ka dëshmuar në mënyrë të mjaftueshme pretendimin e tij.
43. Rrjedhimisht, kërkesa është qartazi e pabazuar në baza kushtetuese dhe duhet të deklarohet e papranueshme.

Kërkesa e parashtruesit për moszbulim të identitetit

44. Gjykata rikujton se parashtruesi në kërkesën e tij ka paraqitur kërkesë për moszbulim të identitetit për shkak të miturisë së tij.
45. Lidhur me këtë, Gjykata i referohet rregullit 29 (6) të Rregullores së punës, i cili parasheh që:

“Pala që parashtron kërkesë mund të kërkojë që identiteti i tij ose i saj të mos zbulohet publikisht dhe të paraqesë arsyet për këtë kërkesë. Gjykata mund të aprovojë kërkesën nëse vërteton se arsyet janë të bazuara mirë.”

46. Gjykata duke marrë për bazë moshën e mitur të parashtruesit, si dhe në pajtim me nenet 8 dhe 40 të Konventës për të Drejtat e Fëmijës që, sipas nenit 22 [Zbatimi i Drejtpërdrejtë i Marrëveshjeve dhe Instrumenteve Ndërkombëtare] të Kushtetutës, “zbatohen drejtpërdrejtë në Republikën e Kosovës dhe kanë prioritet, në rast konflikti, ndaj dispozitave e ligjeve dhe akteve tjera të institucioneve publike” aprovon kërkesën e tij për moszbulim të identitetit.

PËR KËTO ARSYE


Gjykata Kushtetuese e Kosovës, në pajtim me nenin 113, paragrafi 7 të Kushtetutës, nenin 48 të Ligjit, rregullat 29 (6) dhe 36 (1) (d) dhe 36 (2) (b) dhe (d) të Rregullores së punës, në seancën e mbajtur më 5 shtator 2017, njëzëri

VENDOS

- I. TA DEKLAROJË kërkesën të papranueshme;
- II. TA MIRATOJË kërkesën për moszbulim të identitetit;
- III. T'UA KUMTOJË këtë vendim palëve;
- IV. TA PUBLIKOJË këtë vendim në Gazetën Zyrtare, në pajtim me nenin 20.4 të Ligjit; dhe
- V. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Gjyqtari raportues

Ivan Čukalović



Kryetarja e Gjykatës Kushtetuese

Arta Rama-Hajrizi

